# DËSHMI ARKIVI

**A-444141**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Akuzat për ryshfet dhe qendrat mashtruese, Zelensky shkarkon Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/akuzat-per-ryshfet-dhe-qendrat-mashtruese-zelensky-shkarkon-prokurorin-e-pergjithshem-te-ukraines/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 18:21:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 18:21:05 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1d216bbe66a27b0821122a81d4030e7968ef5b30feef814d882e81adfa868563` |
| TEKSTI | `6d85fcf0d2550dda0842da6819ae753644beaa710908e69ba58e53b892e54f0c` |
| PAMJA | `5f0ae4f2a100f84dc0d4a6e4098388f8e7707c3777b643a5f87cf8bd3c0a5995` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `73fe60ebd9dbc6159c8f95deda8d6e27d8ae6c27d68c18a48089aa377228f1fc` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/73fe60ebd9dbc6159c8f95deda8d6e27d8ae6c27d68c18a48089aa377228f1fc`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | LAJMI I FUNDIT

# Akuzat për ryshfet dhe qendrat mashtruese, Zelensky shkarkon Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës

14 Shtator 2026 | 20:21

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka shkarkuar nga detyra Prokurorin e Përgjithshëm të Ukrainës, Ruslan Kravchenko, zyra e të cilit akuzohet se ka ofruar mbështetje për qendrat mashtruese të thirrjeve në këmbim të ryshfeteve.

Zelensky deklaroi në Telegram se “Prokurori i Përgjithshëm ka vetëm një rrugëdalje: shkarkimin”, duke u bërë thirrje deputetëve që ta miratonin këtë vendim “pa vonesë”.

Menjëherë pas kësaj, dekreti për shkarkimin e Ruslan Kravchenkos u publikua në faqen zyrtare të Presidencës ukrainase.

Kravchenko, i cili në fillim të shtatorit kishte njoftuar se do të jepte dorëheqjen nga posti, pavarësisht se mohon akuzat, tha të mërkurën se ndodhej “në një mision jashtë vendit”.

“Kam ndërmend t’i informoj partnerët tanë ndërkombëtarë rreth situatës reale brenda shërbimeve antikorrupsion, rreth indikacioneve të një përqendrimi të pakontrolluar të ndikimit nga ana e tyre dhe rreziqeve që sjell një praktikë e tillë”, tha ai në një video të publikuar në kanalin e tij në Telegram.

Kravchenko njoftoi gjithashtu se kishte ngritur një padi kundër drejtorit të Byrosë Kombëtare Kundër Korrupsionit (NABU), Semyon Krivonos, duke e akuzuar atë për “falsifikim të dokumenteve zyrtare”.

Në fillim të shtatorit, NABU hetoi Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe njoftoi se kishte zbuluar një rrjet që merrte para për të mbrojtur qendrat e thirrjeve që organizonin mashtrime telefonike dhe “pastronin miliona dollarë”. Sipas hetuesve, ryshfetet përdoreshin për blerjen e pasurive të paluajtshme, bizhuterive dhe sendeve të tjera me vlerë.

Sipas organizatës së specializuar “Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Transnacional” (GI-TOC), rreth 60 000 persona në Ukrainë punojnë në qendrat e thirrjeve që merren me mashtrime, rreth dy të tretat e numrit të punonjësve të sektorit bankar në vend. Këto mashtrime mund të gjenerojnë deri në një miliard dollarë në muaj.

Korrupsioni ka qenë një problem endemik në Ukrainë prej shumë vitesh. Pas pushtimit rus, janë zbuluar një sërë skandalesh, edhe brenda ushtrisë.

Në vitin 2025, Zelensky u përpoq ta vendoste NABU-n nën varësinë e Prokurorit të

LAJMI I FUNDIT

20:21 Poloni, ushtria gjen një dron rus në Detin Baltik

20:11 Reperi amerikan Macklemore largohet nga turneu i Ed Sheeran pas deklaratave pro-palestineze

20:08 Të rinjtë shqiptarë dhe kroatë bashkohen në Tiranë “për të ardhmen e përbashkët evropiane”

20:08 Microsoft ka publikuar rregulla të reja për kontrollin mbi Inteligjencën Artificiale

20:07 Turqi, autoritetet vënë në shënjestër serialin e famshëm

20:00 Lumir Abdixhiku: Bekim Sejdiu tregoi dinjitet

TESTIM

Përgjithshëm, duke i hequr kështu agjencisë pavarësinë, por u detyrua të tërhiqej pas reagimeve si nga shoqëria ukrainase, ashtu edhe nga aleatët perëndimorë të Kievit.

There is only one path for this Prosecutor General: removal from office. That is what I told him. Ukraine has seen all the reasons why. If he considers this political pressure, he is free to call it that. I ask parliamentarians to support his removal without delay.

— Volodymyr Zelenskyy / Володимир Зеленський (@ZelenskyyUa) September 14, 2026

Zelenskiy wants swift exit of Ukraine's prosecutor general as graft clashes plague government https://t.co/il4xl0YEOT https://t.co/il4xl0YEOT

— Reuters (@Reuters) September 14, 2026

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

### Reperi amerikan Macklemore largohet nga turneu i Ed Sheeran pas deklaratave pro-palestineze

Reperi amerikan Macklemore nuk do të performojë në datat e mbetura të turneut të Ed Sheeran në stadiumet amerikane, pasi disa prej vendeve ku janë planifikuar koncertet dyshohet se kanë kundërshtuar pjesëmarrjen e tij për shkak të...

20:11 | 14/09/2026

BOTA | EURONEWS ALBANIA

### Microsoft ka publikuar rregulla të reja për kontrollin mbi Inteligjencën Artificiale

Microsoft ka publikuar një draft të ri për rregullimin e sistemeve të saj të inteligjencës artificiale, duke propozuar një kornizë sigurie që synon të garantojë...

20:08 | 14/09/2026

BOTA

### Turqi, autoritetet vënë në shënjestër serialin e famshëm

Seriali turk " Kurtlar Vadisi " (Lugina e Ujqërve), një nga prodhimet më të njohura dhe më popullore në historinë e televizionit turk, është vënë...

20:07 | 14/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.